Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Gjemajli Bellanica;	10.05.2022	20.05.2022	*126/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 05.05.2022 OE "**ENG IDEA**" sh.p.k Suharekë**,** ka parashtruar ankesë me nr. 126/22 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetit e prokurimit me titull: "**Hartimi i projekteve për objekte në Pronë Komunale**", me nr. të prokurimit: **642-22-1188-2-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK –Mitrovicë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar kontratë publike kornizë me një operator ekonomik, procedurë të hapur, Shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 124 990.00 €

Data e njoftimit për kontratë.....09.03.2022.
Hapja e ofertave.....21.03.2022.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....08.04.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....13.04.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....15.04.2022.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së lidhur me njoftimin për anulimin e aktivitetit te prokurimit 24.04.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....25.04.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....26.04.2022

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE "**ENG IDEA**" sh.p.k Suharekë

Dispozitat e shkelura

Neni 1 – Qëllimi
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 10 – Mjetet për promovimin e transparencës
Neni 55 – Mënyra e komunikimit
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 61 – Tenderët e ulët jasht normales
Neni 41 të RRUOPP
Neni 44 i RRUOPP
Neni 47.23 i RRUOPP
Neni 59.3 LPP-RRUOPP

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Ne pergjgjen kerkeses se pare per Rishqyrtim AK, flet per shfrytezimin sa me ekonomik te buxhetit, lidhet me nenet 65 deri 69 te LPP, duke i anashkaluar komplet nenet kryesor te ligjit, qe tregon se AK, ne LPP ka perdorur vetem nenet qe mbeshtesin anulimin e tenderit, por ne asnje moment nuk ka marre perbaze nenet qe ruajne bazen e e LPP dhe te drejten e OE, Neni 1 Qëllimi, Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo – Diskriminimi Pretendimi si dhe Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tendereve, duke demtuar keshtu interesin e paleve ne procedure dhe duke demtuar buxhetin e Republikes se Kosoves duke i dhene mundesine e rikonkurimit kompanive qe nuk japin sherbime efikase, duke vonuar perzgjedhjen e OE permes rihapjes se procedures e cila ne kohen kur cdo cmim po rritet do te rezultonte me rritje edhe te ofertave. Per me teper, AK tashme ka hapur ofertat, dhe teknika e pergatitjes se ofertave dhe cmimet e OE jane zbuluar, e bene kete vendim te papranueshem per anulimin e procedures se prokurimit ne tersi, e aq me teper eshte edhe e pabazuar ne Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe RRUOPP-se te KRPP-se.

Pretendimi 1: Së pari pajtohemi plotesisht per vendimin mbi anulimin e Njoftimit te Vendimit te date 08.04.2022 ku propozohet per shperblim me kontrat grupim i OE (Studio Hapsira) për të cilin vendim kemi paraqitur arsyet-pretendimet tona ne Kerkesen per rivleresim të datës 13.04.2022. Kerkesa jone per rivleresim te vendimit ka ardhur pas verifikimit te dokumentacionit të ofruar nga grup i OE Studio Hapsira dhe Taulant shpk dhe mangesive te verejtura gjate verifikimit te dosjes se tyre e ne veqanti çmimeve të cilat rezultuan të jenë gabime të papërmirësueshme për të ngelur në fuqi Njoftimi i Vendimit të datës 08.04.2022 ku propozohen per tu shperblyer me kontrat grupi i OE Studio Hapsira dhe Taulant shpk, që realisht është grupi i OE i papërjegjshem në këtë procedurë të prokurimit. Se pari **ka gabim aritmetik në kalkulimin e cmimeve me shume se ± 2% të vlerës së paraqitur në cmimet baze** të tyre. Po ashtu kanë paraqitur në totalin e rikapitulimit renditja 8 vlerë 0.00 € me qëllim që mos të paraqesin cmim me vlere numerike prej tre numrash pas presjes dhjetore e cila do ta eleminonte gjithesesi. Kerkesa jonë për të anuluar njoftimin per Vendimin e AK doli te jete e drejtë.

Përmbldhje				
Pjesët	Nën totali	Gjithësej Totali me TVSH	Peshimi i cmimit sipas rëndësisë	Çmimi i peshuar
1	Nën totali i pjesës 1	4.85 €	30.00%	1.46 €
2	Nën totali i pjesës 2	0.72 €	5.00%	0.04 €
3	Nën totali i pjesës 3	1.82 €	15.00%	0.27 €
4	Nën totali i pjesës 4	2.77 €	15.00%	0.42 €
5	Nën totali i pjesës 5	1.90 €	5.00%	0.10 €
6	Nën totali i pjesës 6	1.02 €	15.00%	0.15 €
7	Nën totali i pjesës 7	0.12 €	5.00%	0.01 €
8	Nën totali i pjesës 8	0.08 €	5.00%	0.00 €
9	Nën totali i pjesës 9	0.90 €	5.00%	0.05 €
TOTALI 1+2+3+4+5+6+7+8+9 me të gjitha taksat e aplikueshme në Kosovë		14.18 €	100.00%	2.48 €

Pra, pretendimi yne në këtë pikë eshte qe grupi i OE Studio Hapsira dhe Taulant shpk,

ne fazen e rishqyrtimit të vlerësohet drejte dhe konform ligjit te LPP-se dhe RRUOPP-se Neni 41.7,41.8 41.9 dhe 47.23 si I PAPERGJEGJSHEM.

Pretendimi 2: AK me rastin e publikimit të vendimit për anulimin e vendimi të njoftimit të datës 08.04.2022 dhe vendimit per anulimin e procedures se prokurimit bene diskriminim te dukshem te OE ofertues, kur njoftimin drejtuar zyrtarisht e bene vetem per te te propozuarin per shperblim me kontrate ne njoftimin e vendimit të dates 08.04.2022, sikur pale me interes ne kete procedur prokurimi te ishte i vetem! **Ofertuesit e tjere si pale interesi fare nuk i perfshin në "dokumentin zyrtar", te njoftimit te vendimit te datës 22.04.2022.**

Per t'u ndjekur hapat zyrtar dhe ne perputhje me LPP-ne dhe RROUPP-ne AK paraprakisht duhet te merrte vendim per anulimin e njoftimit te Vendimit te publikuar me date 08.02.2022, kete AK duhet ta bente me formularin standard B 58, dhe me pas te publikohet njoftimi i vendimit per anlimin e procedures me formularin standard B 58 duke ju drejtuar te gjitha paleve me interes perfshi te gjithe OE ofertues.

AK ne kete dokument nuk ka dhene fare keshillen jurdike e te drejtes per ankese mos pajtim te palëve në interes në këte procedur të prokurimit. Pra, edhe ne kete pike AK bënë shkelje te LPP, te cilin veprim e perserit prap ne pergjigjen e tjeter Kerkeses tone per Rivleresim te vendimit per Anulmin e tenderit. Pra, prap nuk jep asnje keshill juridike!

Pretendimi 3: Në asnje menyrë nuk është i drejtë vendimi per anulimin e komplet procedurës së prokurimit sepse eshte ne kundershtim me Nenin 44 pika 44.5 dhe 44.6 ku qarte percaktohen arsyet per anulimin e nje procedure te prokurimit.
Ne njoftimin e vendimit te AK të datë 08.04.2022 të gjithë aplikuesit në këtë procedurë të prokurimit rezultonin të përgjegjshem por të ,, pa suksesshem ".

E kemi lexuar me shume kujdes arsyeshemrin e paraqitur nga AK për vendimin e anulimit të procedurës së prokurimit, njesoj sic kemi verifikuar edhe dokumentacionin e te gjithe ofertuesve pas realizimit te qasjes ne dokumentacionin zyrtar realizuar me date 12.04.2022 para paraitjes se kerkeses se pare per Rivleresim te dates 13.04.2022.

1.► Ne si AK Komuna e Mitrovicës me zbatimin LPP-së fuqi na obligon që të zbatohet LPP-ja me kujdes dhe te ruhet paraja publike dhe ne A.K. Komuna e Mitrovicës e kemi vlerësuar tenderin me qmimin e ofertuar më të ulët dhe kemi kontrolluar dokumentacionin e tenderit ne tërësi sipas Nenit ,65,66,67 68 dhe 69 dhe gjithashtu kemi kontrolluar edhe përshkrimin e qmimeve dhe kemi vërejtur disa pozicione me qmime 0.00 € të prezentuara te O.E.

Eshte plotesisht i pavertet, dhe i paqendrueshem konstatimi se nuk ka cmime ne pozicionet e ofruar nga OE. Është e kunderta te gjithe ofertuesit kane ofruar cmime ne te gjitha pozicionet. Perveq te te propozuarit per kontratë ne njoftimin e Vendimit te dates 08.04.2022 i cili ne Rikapitulimin e cmimeve Poz 8 e ka vendosur me vlere 0.00 € që automatikisht duhet te eleminohej nga kjo procedure e prokurimit. Kete e ka bere me qellim qe kur te shumezoj vleren e cmimit te ofruar ne € me peshim te mos kete vlere me tre numra pas presjes dhjetore sepse me ligj te LPP-se duhet te eleminohej. Megjitate, po e ritheksojme se edhe me vendosjen e shifres 0.00 sic ka vepruar grupi i OE Studio Hapsira dhe Taulant shpk duhej te eleminhej e jo te propozohej per shperblim me kontratë.

Po rikthehemi te arsyetimi i AK se të gjithë Ofertuesit nuk kane cmime, është e pasakt, cmime kanë ne pozicionin perkates por nuk kane mbledhur vlerat e cmimeve per projekt ideor dhe projekt kryesor te poz 8, pika 2 e Paramases me përjashtim të OE Arhiko i cili e ka bere permiresimin e llogarise dhe ka vendosur totalin me vlere ne €.

Po ashtu konstatimi i AK ne piken 2 te arsyetimit se ***„gabimet janë të paramasës"*** eshte i pa sakt sepse paramasa nuk ka gabime, gabimi eshte ne llogari.

2.► Mirërpo pas kërkesës së disa OE per qasje në DT të O.E. të propozuar dhe pas kërkeses për Rishqyrtim te ktyre O.E. kemi hasur ne disa gabime te NENI II Përshkrimi i qmimit te cilat gabime janë te paramasës [i kanë potencuar edhe O.E. jo para hapjes por pas hapjes se ne si Zyre nese e kishim vrejtur para hapjes kishim tentue me përmirsue] te cilat i ka gjenerue vetë Sistemi Excel i Eplatformes nga i cili gabim ka ndodh te të gjithë O.E. dhe se në këtë kolonë e kemi qmimin me 0.00 €.

Nr.	Lloi i objektit ndërtimor	Emri i objektit ndërtimor	Tipi i objektit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me Tvsh, per Projekt Ideor	Çmimi njësi me Tvsh, per Projekt Kryesor	TOTALI ME TVSH	Pikët e poentimit
2.0	OBJEKTE BANUESE	Shtëpi Banimi	Ndërtim i ri	1	m²	0.01 €	0.01 €	0.02 €	Pesha e përqindjes 5%
			Renovim	1	m²	0.01 €	0.01 €	0.02 €	
		Objekt shumëbanesor, Objekt shumëbanesor me karakter social.	Ndërtim i ri	1	m²	0.01 €	0.01 €	0.02 €	
			Renovim	1	m²	0.01 €	0.01 €	0.02 €	
			Dizajn i brendshëm	1	m²	0.01 €	0.01 €	0.02 €	
			Dizajn i jashtëm-m² për sipërfaqe vertikale te objektit.	1	m²	0.30 €	0.30 €	0.60 €	
		Objekt për vendstrehim per viktimat e dhunes në familje	Ndërtim i ri	1	m²	0.01 €	0.01 €	0.02 €	
			Renovim	1	m²	0.30 €	0.30 €	0.00 €	0.60 €
Nën totali i pjesës 2								0.72 €	1.32 €

Nuk eshte mungese cmimi ne pozicione por mos perfshirje e cmimit ne llogarine perfundimtare andaj nuk vlen Neni 41.15 ne te cilin eshte thirrur AK.

Pra, **gabimi është plotesisht aritmetik** e nuk mungon cmimi ne pozicione-pozicionet kane cmimet njesi te qart me TVSH (sic ka deklaruar AK ne arsyeshmerin ne Vendim per anulim te Procedures) dhe AK ne këtë rast duhet të kalkuloj ndryshimin e cmimit dhe këtë e ka shume të qartë sespe e ka deshmuar edhe në përgjigjen ne Kerkesen tone per Rivlersim por ka ngaterruar nenin 41.7,41.8, 41.9 dhe 47.23 me nenin 41.15 shih pergjigjen e AK, aprovimin e kërkesës tonë për rishqyrtim.

Po ju rikujtojme Nenin 47.23 te RRUOPP-se.

47.23 Në lidhje me Nenin 59.3 të LPP **autoriteti kontraktues mund të korrigjoj gabimet plotësisht aritmetike në tender, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës**. Njoftimi për tenderuesin përkatës për korrigjim të tillë të një tenderi do të bëhet me anë të përdorimit të formularit standard të aprovuar nga KRPP-ja B49. Megjithatë, në asnjë rast nuk mund korrigjohet çmimi për njësi. Për më tepër shih nenin 41 të këtyre rregullave dhe këtij udhëzuesi.

PRETENDIMI IV-Të.

4.Përgjigje- :-Kurse sa i përketë kti pretendimi është qështje kryekput e Zyres se Prokurimit dhe shihet qartë se te Pozicioni 2.0 Objekte Banuese –Objekte për vendëstrehim për viktimat e dhunës në familje te pozicioni numër 8 Renovim te Kolona A qmimi për njësi me TVSH –Projekti Ideor -0.30 € cent dhe te Kolona B qmimi për njësi me TVSH –Projekti Kryesor -0.30 € cent kurse te nëntotali i ktyre dy qmimeve që duhet të jetë =0.60 € cent kurse është 0.00 € [ku ne si Zyre e Prokurimit dhe A.K. qmimet për njësi nuk guxojm ti korigjojmë ose ti ndryshojmë] ku sipas RRUOPP neni 41.15 duhet ti dërgohet O.E. pytje sqaruese ti kërkohet sqarim për pozicionin 0.00 € cent ku duhet te pergjigjet sipas nenit 41.15 pikë 1 dhe pikën 2 te kti neni .

Pavarsisht edhe nëse i përmirsohet Nëntotali sepse qmimin për njësi sipas LPP-së nuk lejohet pëmirsimi ather duhet llogaritur vlera totale a e tejkalon vlerën 2 % ? ku sipas RRUOPP te neni 41.8 pika ii thuhet citoj –nese shuma e korigjimit është më shumë se +/ - 2% te vlerës Totale, AK do te eliminoj O.E. dhe do të informojë O.E. duke e përdor formen standarde B42.

►A.K. Komuna e Mitrovicës JUGORE duke pas parasysh arsyet e cekura më lartë dhe duke e zbatuar LPP-në dhe RRUOPP vjen në përfundim dhe vendosi në dispozitiv si më poshtë: APROVOJ ANKESËN [KËRKESËN PËR RISHQYRTIM] si pjesërisht BAZUAR për ENG IDEA SH.P.K., Brigada 123, 23000, Suhareke dhe Lënda të kthehet në RIVLERËSIM dhe shqyrtohet vendimi i A.K. për Anulim te Vendimit te AK.për propozim për kontratë.

Pra, qarte thuhet se nuk mund te korrigjohet çmimi njesi (ne kete rast nuk do korigjim cmimi njesi) e nese cmimi njesi mungon apo eshte me vlere 0 ateher merret ne konsiderate neni 41.15.
Po ashtu shih nenin 41.7,41.8 dhe 41.9 ne baze te te cilave duhet vleresuar ky rast:

41.7 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht të sqaroj tenderin e tij /saj. Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen vetëm me shkrim, por asnjë ndryshim në çmim ose në ndonjë kusht ose aspekt material të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet.

41.8 AK do të përmirësojë gabimet plotësisht aritmetike në tender nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës.

i. Ne rast se shuma e korrigjuar është **me pak se +/- 2%, AK do te përmirësoj gabimet e tilla** dhe do te informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur **formën standarde B49.** Ne rast se OE ne fjale nuk pranon përmirësimin e gabimit, oferta ne fjale do te refuzohet. AK gjithashtu duhet ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës (OE te cilët kane dorëzuar tender) një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.
ii. Ne rast se shuma e korrigjuar është **me shume se +/- 2%, AK do te eliminoj OE** dhe do te informoj me shkrim OE ne fjale duke përdorur formën standarde B42.

41.9 Tenderuesi do të informohet me shkrim menjëherë për korrigjime të tilla. Gabimet në llogaritjen e çmimit do të korrigjohen nga AK në këtë mënyrë:

a. *Në rast se ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe çmimit total* që është marrë duke shumëzuar çmimin për njësi dhe sasisë, *çmimi i njësisë mbizotëron* dhe çmimi total do të korrigjohet;

Po ju rikujtojme edhe Nenin 44.5 dhe 44.6 RRUOPP-se kur nje procedure e prokurimit mund te anulohet pas hapjes se tenderit.

44.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:
(i) asnjë tenderë nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;
(iii)numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE - është më pak se 3;
(iv)nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(v) numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;
(vi)nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;
(vii) asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm; (viii) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;
(ix)një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
(x) nëse AK gjate përgaditjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose
(xi) nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

44.6 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 99
(i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.

Asnje nga pikat e lartecekura nuk eshte e plotesar qe t'i jap te drejte AK të anuloj këtë procedurë të prokurimit.
Ne arsyetimin 3 te AK ne vendimin per anulim te vendimit të procedures se prokurimit ka paqartesi dhe pasaktesi.

3.► Duke e ditur se te LPP-ja dhe te RRUOPP te neni 41.15 i ktyre Rregullave nuk lejohen qmimet me 0.00 € dhe ofertat duhet te refuzohen dhe në konsultim me Departamentin e Rregullave në KRPP dhe duke ju sqaruar rastin se ka ndodhë me sistemin EXCEL te Eplatformes Elektronike Departamenti i Rregullave na sygjeroi qe kjo procedurë te anulohet dhe Pershkrimi i Qmimeve të verifikohet dhe të rregullohet dhe të shpallet përseri me Pershkrim te rregulluar.

Se pari, AK nuk paraqet asnje deshmi komunikimi me KRPP ne lidhje me kete procedure te prokurimit, dhe e dyta AK eshte ngaterruar te Neni 41.15 i cili flet per munges te cmimit njesi qe ne kete rast nuk ka mungese te cmimeve njesi. Me pas AK krijon konfuzion duke deklaruar se po citoj: ,, ka ndodhur me sistemin EXEL te Platformes Elektronike". Ne sistemin EXEL nuk mund te kete leshime dhe mos funksonim te till, por ketu eshte paraqitur nje gabim njerzor (me apo pa qellim) dhe nuk ka te beje me sistemin. Megjithate, të gjithë OE qe kane ofertuar duhet te ishin të kujdesshem gjate vendosjes dhe kalkulimit te cmimit te ofertes se pari te vendosin cmime njesi ne te gjithe pozicionet e paramases e pastaj te kontrollojne kalkulimin perfundimtare sepse te gjithe jane te vetedijshem se me rastin e gabimit aritmetik mbi

± 2% do te eleminohen. Ka nga OE ofertues qe e kane verejtur dhe e kane permiresuar kete leshim teknik.

AK e ka shumë mirë të ditur rrugën e zgjidhjes së kësaj qështje sepse e ka përshkruar shume qarte si me siper. Pra, sic ka përshkruar cmimet per poz. e grupit të OE Studio Hapsira dhe Taulant shpk si me siper të gjithë ofertuesit kanë cmimet e tyre në pozicione, por ndryshimi i vleres mbi ± 2% paraqitet vetem të grupi i OE Studio Hapsira dhe Taulant shpk, andaj është i pabazuar ne ligj, i çuditshëm dhe i papranueshem Vendimi për Anulimin e komplet procedures!

Meqe, AK nuk ka merr parasysh kerkesen tone per rishqyrtim jemi detyruar qe t'i drejtohemi instancave me te larta ligjore lidhur me kete procedur prokurimi, konform Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Pretendimi 4: AK menjeher pas kerkeses tone per Rishqyrtim te vendimit derguar me date 25.04.2022 e ora 17:05 akoma pa u plotesuar 24 ore pra me 26.04.2022 ne ora 16: 36 jep pergjigje ne refuzimin e kerkeses tone per Rivlersim te vendimit mbi anulimin e procedures se prokurimit ne fjale. Menyra se si eshte perpiluar pergjigjeja eshte e habitshme! Nuk eshte analizuar asnje prej pretendimeve tona dhe nuk eshte kthyer pergjigje per pretendimet tona te paraqitura ne kerkesen per rivleresim. Nese e lexon me vemendje kerkesen tone per Rivleresim dhe pergjigjen e AK merr pergjigje bindese se perfaqesuesit e AK nuk e kane lexuar fare kerkesen per rivleresim.
Arsyeshmerin e vendimit se pari e fillojne me nje pershkrim te quditshem duke u thirrur ne veten e pare njejes „une" sikur institucioni eshte personal i tij, me pas „ankohet" së kërkesa për rishqyrtim eshte shkruar ne 10 faqe! Shkohet aq large sa qe behet nje krahasim i pakuptimt! (shih pergjigjen e AK te dates 26.05.202) Per per kete fakt dhe shkeljeve te shumta qe jane bere ne kete procedure prokurimi ju kemi drejtuar edhe zyres se Monitorimit ne KRPP.

Ne si OE ofertues ne kete procedure te prokurimit jemi pale me interes ne kete procedur dhe jemi të përgjegjshem në të gjitha kërkesat e FDT dhe kushteve te tenderit.

Andaj, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit të marr në konsideratë Ankesen tonë të shqyrtoj atë dhe të merr vendimin per anulim e vendimit të AK dhe të kthej lëndën në Rivleresim, ta anuloj kete vendim (marr parasysh ligjin dhe RROUPP-ne nenin 47.23, 41.7, 41.8, 41.9 ne baze te te cilit duhet trajtuar) dhe të shpall njoftimin per vendimin e dhenies se kontrates OE te pergjegjshem me cmimin me te ulet qe ne kete rast eshte ENG IDEA shpk.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

1.] Regjistrimi i OE në regjistrin profesional, komercial ose korporatës në vendin e themelimit e përkthyer në gj.shqipe, angleze ose sërbe. (Ofertuesi jo rezident sipas Ligjit aktual të Kosovë LPP Nr. 04 L-042) është i detyruar të paraqesë certifikatën e regjistrimit të njësisë përhershme-para nënshkrimit të kontratës
2.] Regjistrimi i TVSH;

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1]. OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE, gjate 3 viteve te shkuara ka qene ne vlere, se bashku ne të tri vitet, prej jo me pak se: 240,000 Euro.

(periudha e shkuar tre vjeçare konsiderohet nga data e publikimit të njoftimit për kontrate).

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

A]. Lista e projekteve të realizuara në 3 vitet e shkuara [fundit], përfshirë projektet e reja dhe renovim.

Projekte për projektim mbi 2000 m2 objekte me të gjitha fazat dhe Projekte për renovim mbi 2000 m2.

(periudha e shkuar tre vjeçare konsiderohet nga data e publikimit të njoftimit për kontrate)

B]. Të dhënat e personelit udhëheqës të OE dhe ekipës që drejtpërdrejt janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve, me të cilat dëshmohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve.

C]. Certifikatë profesionale:

ISO 9001 2015,.

D]. Dëshmi për Obligimet e përfunduara Komunale. [Tatimi në Pron].

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

Dëshmia 1.- Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);

2.] Kopja e TVSH-se;

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Dëshmia 1.- Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e shkuara .

(periudha e shkuar tre vjeçare konsiderohet nga data e publikimit të njoftimit për kontrate)

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Dëshmia A.- Listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkruar nga autoriteti publik: (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë;

Dëshmia B.- Lista e personelit udhëheqës dhe ekipës që drejtpërdrejt janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve në veçanti, të dhënat lidhur me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë.

Dëshmia C. -Certifikata duhet të jetë origjinale ose kopje e noterizuar si dhe valide.

Dëshmia D.- Dëshmi për Obligimet e përfunduara Komunale. [Tatimi në Pron].

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

ANULOJ NJOFTIMIN MBI VENDIMIN E A.K. te DATËS 08/04/2022 dhe të ANULOJ PROCEDURËN E PROKURIMIT dhe pas përmirsimit te Pershkrimit te qmimit te RITENMDEROHET sepse A.K. ka interes për këto shërbime dhe kjo procedurë te vazhdoj më tutje .

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "ENG IDEA" sh.p.k Suharekë

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE pretendon se OE i propozuar për kontratë është i pa përgjegjshëm në këtë procedurë të prokurimit, për shkak se ka gabim aritmetik në kalkulimin e çmimeve me shumë se +/- 2% të vlerës së paraqitur në çmimet bazë të tyre. Po ashtu kanë paraqitur në totalin e rikapitulimit renditja 8 vlerë 0.00 Euro me qëllim që mos të paraqesin çmim me vlerë numerike prej tre numrash pas presjes dhjetore e cila do ta eliminonte gjithsesi.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar dokumentacionin e ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit thekson se GOE "Studio Hapsira dhe Taulant sh.p.k" në paramasën e ofruar nga ana e tyre tek përmbledhja, pjesa e tetë (8), nën totali i pjesës tetë (8), ka vendosur çmimin 0.00.Andaj në këtë rast vlen neni 41.15 i RRUOPP dhe pyetja me nr. 29 tek pyetjet e shpeshta të KRPP-së.

Në dokumentet e ofruar në E prokurim nuk është gjendur ndonjë dëshmi që AK-ja ka konstatuar që ka gabime aritmetike ashtu siç pretendon OE ankues, mirëpo eksperti shqyrtues thekson se pasi çmimet për njësi janë

dhënë dhe tek pjesa e dytë e paramasës konkretisht tek tipi i objektit (Renovim) nuk është bërë mbledhje e shumës, eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit AK-ja të konstatoj nëse gabimet e tejkalojn +/- 2% të vlerës së paraqitur.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues thotë se AK me rastin e publikimit të vendimit për anulimin e vendimit të njoftimit të dt. 08.04.2022 dhe vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit bënë diskriminim të dukshëm të OE ofertues, kur njoftimin drejtuar zyrtarisht e bënë vetëm për të propozuarin për shpërblim me kontratë në njoftimin e vendimit të dt. 08.04.2022, sikur palë me interes në këtë procedurë të prokurimit të ishte i vetëm. Ofertuesit e tjerë si palë interesi fare nuk i përfshinë në " dokumentin zyrtar", të njoftimit të vendimit të dt. 22.04.2022.

AK-ja ka bërë shkelje të LPP-së, të cilin veprim e përsërit prap në përgjigjen tjetër të kërkesës tonë për rivlerësim të vendimit për anulimin e tenderit. Pra, prap nuk jep asnjë këshillë juridike.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se me dt. 08.04.2022, AK-ja ka publikuar njoftimin mbi vendimin AK-së, si dhe letrën standarde për tenderues të suksesshëm dhe letër standarde për tenderues të pa suksesshëm. Në platformën E prokurim, ky dokument i AK-së nuk është i ngarkuar si dokument tek dokumentet tjera aty ku do të duhej të ngarkohej formulari standard (B 46).

Ndërsa me dt. 22.04.2022 AK-ja ngarkon në E prokurim dokumentin, njoftim mbi vendimin e AK-së ku vendos për anulimin e procedurës së prokurimit, mirëpo ky vendim nuk është përcjell me letër standarde për tenderues të pa suksesshëm si dhe nuk i është saktësuar këshilla juridike, e cila do duhej të shkruhej ashtu siç parashihet në nenin 108/A dhe 109 të LPP-së. Andaj eksperti shqyrtues rekomandon që AK-ja duhet të veproj konform dispozitave ligjore të parapara me LPP dhe RRUOPP dhe t'i trajtoj të barabartë të gjithë OE pjesëmarrës në procedurë të prokurimit.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE thotë se në asnjë mënyrë nuk është i drejtë vendimi për anulimin e komplet procedurës së prokurimit sepse është në kundërshtim me Nenin 44 pika 44.5 dhe 44.6 ku qartë përcaktohet arsyet për anulimin e një procedure të prokurimit. Është plotësisht i pa vërtet, dhe i pa qëndrueshëm konstatimi se nuk ka çmime në pozicionet e ofruara nga OE. Është e kundërta, të gjithë ofertuesit kanë ofruar çmime në të gjitha pozicionet. Përveç të

propozuarit për kontratë në njoftimin e vendimit të dt. 08.04.2022 i cili në rekapitullimin e çmimeve Poz. 8 e ka vendosur me vlerë 0.00 Euro që automatikisht duhet të eliminohej nga kjo procedurë e prokurimit. Këtë e ka bërë me qëllim që kur të shumëzoj vlerën e çmimit të ofruar në Euro me peshim të mos ketë vlerë me tre numra pas presjes dhjetore sepse me ligj të LPP-së duhet të eliminohej. Megjithatë po e ritheksojmë se edhe me vendosjen e shifrës 0.00 siç ka vepruar GOE "Studio Hapsira dhe Taulant sh.p.k" duhet të eliminohej e jo të prezantohej për shpërblim me kontratë. Arsyetimi i AK-së se të gjithë ofertuesit nuk kanë çmime, është e pa saktë, çmime kanë në pozicione përkatëse por nuk kanë mbledhur vlerat e çmimeve për projekt ideor dhe projekt kryesor poz. 8, pika 2 e paramasës me përjashtim të OE "Archiko" i cili e ka bërë përmirësimin e llogarisë dhe ka vendosur totalin në Euro.

Po ashtu konstatimi 2 i AK-së në pikën 2 të arsyetimit " gabimet janë të paramasës" është i pa saktë sepse paramasa nuk ka gabime, gabimi është në llogari.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se në ofertat e prezantuar nga operatorët ekonomik nuk ka ndonjë mungesë çmimi në pozicione për të cilat duhet të eliminohet aktiviteti i prokurimit, mirëpo në paramasat e ofruara ku shkruan tipi i objektit, RENOVIM është vendosur çmimi por nuk është bërë mbledhja dhe ka mbet shifra totali me TVSH 0.00. Përveç kësaj OE i rekomanduar për kontratë në paramasë tek përmbledhja(rikapitulimi) nën totali tetë (8) e ka me shifër 0.00, që bie ndesh me Nenin 41.15 të RRUOPP-së dhe pyetjes nr. 29 të KRPP-së tek pyetjet e shpeshta.

Andaj, pasi që nuk ka gabime në paramas mirëpo ka gabime në llogaritje, eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit AK-ja të konstatoj nëse operatorët ekonomik kanë tejkaluar gabimet aritmetikore +/- 2%, dhe të veprohet konform nenit 59 të LPP-së dhe konform nenit 47.23 të RRUOPP-së.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues thotë se AK menjëherë pas kërkesës tonë për rishqyrtim të vendimit të dërguar me dt.25.04.2022 ora 17:05, akoma pa u plotësuar 24 orë, pra me 26.04.2022 në ora 16:36, jep përgjigje në refuzimin e kërkesës tonë për Rivlerësim të vendimit mbi anulimin e procedurës së prokurimit në fjalë. Mënyra se si është përgatitur përgjigjja është e habitshme! Nuk është analizuar asnjë prej pretendimeve tona dhe nuk është kthyer përgjigje në pretendimet tona të paraqitura në kërkesë për rivlerësim.

Në përgjigje të kërkesës për rishqyrtim të dt. 26.04.2022 AK-ja nuk i është përgjigj pretendimeve ankimore të OE ankues ashtu siç e obligon paragrafi 9 i Nenit 108/A të LPP-së. Gjithashtu referimi i nenit 41.15 i RRUOPP-së, është i gabuar dhe eksperti shqyrtues rekomandon që gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimin e tenderëve AK-ja ta bëjë konform dispozitave ligjore të Nenit 59 të LPP-së si dhe dispozitat e RRUOPP-së, si dhe dispozitat ligjore t'i përdorë në formë adekuate.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "ENG IDEA" sh.p.k Suharekë të aprovohet si e bazuara, dhe rekomandon që të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - KK - Mitrovicë
Panelit Shqyrtues - OSHP
OE ankues -OE "ENG IDEA" sh.p.k Suharekë